

Vendim nr. 75 datë 11.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 11.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (F) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FATMIR NDREU**, përfaqësuar nga avokate Markela Gega, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i pjesshëm i vendimit nr. 10632, datë 21.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 264, datë 16.09.2020 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2023-3120, datë 19.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57, 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Fatmir Ndreu ka qenë në marrëdhënie pune pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (*OST*) sh.a. prej vitit 2008, me kontratë me afat të pacaktuar, fillimisht me detyrë elektrikist i kualifikuar në turn, pranë njësisë operative Tiranë dhe së fundi përgjegjës i ndërresës në sektorin e shfrytëzimit.

2. Me shkresën e datës 24.01.2018, OST sh.a. ka njoftuar kërkuesin lidhur me përfundimin e kontratës së punës dhe arsyet e përfundimit të saj. Në datën 05.02.2018 është caktuar një takim ndërmjet palëve, i cili është shtyrë për një datë të mëvonshme, pasi kërkuesi ka qenë me raport mjekësor nga data 17.01.2018 deri në datën 03.03.2018. Në datën 08.02.2018 kërkuesi është paraqitur në OST sh.a. dhe ka dorëzuar parashtrimet e tij me shkrim për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, duke pretenduar se ndërprerja e marrëdhënies së punës ishte e paligjshme dhe se në momentin e ndërprerjes së kësaj marrëdhënieje kërkuesi ka qenë me raport mjekësor. Pas këtij takimi, kërkuesi nga data 09.02.2018 e në vijim nuk është paraqitur më në vendin e punës, pasi njoftimin e datës 24.01.2018 e ka konsideruar si datë të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

3. Me shkresën nr. 1846, datë 06.03.2018, OST sh.a. ka njoftuar kërkuesin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke i bërë me dije, gjithashtu, se marrëdhënia financiare do të përfundonte në datën 07.03.2018.

4. Në datën 19.07.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi, duke kërkuar dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës, dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës dhe afateve të njoftimit, si dhe shpërblim për vjetërsinë në punë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10632, datë 21.12.2018, ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë; detyrimin e OST sh.a. të dëmshpërblejë kërkuesin me pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës sipas nenit 144 të Kodit të Punës; detyrimin e OST-së të dëmshpërblejë kërkuesin me pagën e 12 muajve si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të marrëdhënies së punës; detyrimin e OST-së të dëmshpërblejë kërkuesin me pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit. Gjithashtu, gjykata ka vendosur edhe detyrimin e OST sh.a. të paguajë në favor të kërkuesit si shpërblim për vjetërsi pagën e 5 muajve dhe në llogaritjen e dëmshpërblimit të merret si bazë paga mesatare mujore (bruto) e vitit të fundit të punës. Gjykata e rrethit ka rrëzuar pretendimet

për kthimin në pozicionin e mëparshme dhe pretendimin për përfitimin e vjetërsisë në punë prej 16.5 pagash, me arsyetimin se marrëdhëniet e punës mes palëve kanë filluar në vitin 2008, pra ai ka qenë në marrëdhënie pune me OST sh.a. 10 vjet dhe jo 35 vjet, siç pretendon. OST sh.a. ka detyrimin të paguajë shpërblimin për vjetërsinë në punë në masën 5 paga, pasi periodhat e mëparshme të vjetërsisë nuk mund t'i njihen si detyrim asaj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi dhe OST sh.a.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 264, datë 16.09.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë ka mbajtur të njëjtën linjë arsyetimi si edhe gjykata e rrethit, por duke shtuar në arsyetim se përfitimet e paditësit të njohura me vendimin e gjykatës së shkallës së rrethit të llogariten mbi bazën e pagës që ai ka përfituar në kohën e zgjidhjes së kontratës së punës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3120, datë 19.07.2023, bazuar në nenin 480 të Kodi i Procedurës Civile, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se në rekursin e paraqitur nga kërkuesi nuk janë paraqitur shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, të cilat e bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Nga gjykata e apelit dhe gjykata e rrethit janë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor apo të procedurës së gjykimit. Këto gjykata kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, si dhe kanë kryer një analizë juridike të plotë të provave duke e zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

8. Në datën 05.02.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. ***Kërkuesi*** ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

9.1. *Sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi në rastet kur vendimet e gjykatave të faktit bien ndesh me të drejtën dhe ligjin, Gjykata e Lartë si gjykatë ligji ka detyrimin t'i ndryshojë ato.

9.2. *Mjeteve të jetesës me punë të ligjshme*, pasi kërkuesi ka qenë në marrëdhënie pune me OST sh.a., që prej vitit 1984 kur Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (*KESH*) sh.a. ka pasur në përbërje të saj OST sh.a. Në vitin 2004, kur u realizua ndarja e OST sh.a. nga KESH sh.a., u transferuan edhe të drejtat dhe detyrimet për punëmarrësit dhe punëdhënësit. Në këto kushte, gjykatat e faktit duhet të vendosnin për përfitimin e shpërblimit të vjetërsisë në punë prej 16.5 pagash dhe jo 5 pagash. Vjetërsia në punë duhej të përlllogaritej nga gjykatat nga data 01.04.1984 dhe jo nga data 01.03.2008. Shkëputja nga puna për periudhën 2002-2008 ka qenë për shkak sëmundjeje dhe ndërkohë ka përfituar pension invaliditeti të pjesshëm, për rrjedhojë ajo njihet si periudhë vjetërsie në punë. Gjithashtu, në llogaritjen e dëmshpërblimit nuk janë llogaritur orët e punës së natës me turne, ku sipas nenit 81 të Kodit të Punës përfitohet shtesë prej 20% për orarin nga 19:00-22:00 dhe 50% shtesë për orarin 22:00-06:00.

9.3. *Standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore*, pasi gjykata e rrethit dhe ajo e apelit pa kryer asnjë hetim gjyqësor dhe pa u bazuar në dispozitat ligjore të Kodi i Punës kanë arsyetuar për kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës, duke u shprehur se ajo ka zgjatur mbi 3 vjet, konkretisht 10 vjet dhe për këtë arsye përfiton masën e shpërblimit prej 5 pagash për vjetërsinë në punë. Gjithashtu, nga gjykatat duhej të evidentohet se kërkuesi ka punuar në sistemin energjetik prej 35 vjetësh dhe se OST sh.a. ka qenë pjesë e KESH sh.a., ndarja e të cilit është realizuar në vitin 2004.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit*

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqësorit kushtetues.

12. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka kërkuar shfuqizimin e pjesëshëm të vendimit nr. 00-2023-3120, datë 19.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimi i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor, për rrjedhojë kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, për paraqitjen e ankimit kushtetues individual parashikon afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në rastin konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 19.07.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë, fillimisht, në datën 05.02.2024 dhe pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit 8577/2000, është regjistruar në Gjykatë në datën 14.02.2024. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë nëpërmjet shkresës nr. 1603/1, datë 28.03.2024, rezulton se vendimi i kësaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në datën 21.09.2023. Gjithashtu, Kolegji vë re se kërkuesi në të gjitha

shkallët e gjykimit është përfaqësuar me avokat dhe procesi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në seancë gjyqësore në praninë e palëve, për rrjedhojë kërkuesi ka pasur dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë dhe në kushtet kur nuk ka paraqitur asnjë arsye ose pengesë në lidhje me njoftimet nga ana e Gjykatës së Lartë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa e paraqitur nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.